VENDIM
Nr.40, datë 10.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr. 3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Në pikën I bëhet ky ndryshim:

1. Deputeti Fatmir Xhafaj zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

2. Deputetja Mimi Kodheli zgjidhet nënkryetare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

3. Deputeti Ilir Beqaj zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

4. Deputetja Valentina Leskaj zgjidhet kryetare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

5. Deputetja Ermelinda Meksi zgjidhet kryetare në Komisionin për Integrimin Europian.

6. Deputeti Et'hem Ruka zgjidhet kryetar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

7. Deputetja Arta Dade zgjidhet nënkryetare në Komisionin për Politikën e Jashtme.

8. Deputeti Ilir Gjoni largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

9. Deputeti Namik Dokle largohet nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe zgjidhet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)